



## E K S T R A K T

**I procesverbalit nga mbledhja e tretë të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 25.3.2024, me fillim në orën 14:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Elmira Nikçi Rexha, Oktay Kurtesh, Tiera Kasumi, Faton Marolli, Kineta Shok, Adnan Ajeti.

**Mungoi:** Artan Brahimi.

**Në mbledhje morën pjesë edhe:** Ariona Carraku - zyrtare nga Drejtoria e Kulturës, Lulzim Fushtica - drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, Arianita Beqa Rraci - zyrtare nga UNMIK-u, Klaudia Mula - zyrtare për komunitete nga ZKKK-s, Betim Abdullahu - zyrtar nga ZKKK-s, përfaqësuesit e KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit për Komunitete znj. Mirsada Behluli me këtë:

## R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z. Bekim Brestovci a) diskutim mbi sfidat në rajonet ku jetojnë komunitetet joshumicë, b) koordinim i përbashkët i aktiviteteve gjatë vitit 2024;
3. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit, z. Florian Dushi, a) deponitë ilegale të mbetjeve, b) ndërtimet pa leje;
4. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës, znj. Sibel Halimi;
5. Raporti i ZKKK-s për muajin shkurt 2024;
6. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre;
7. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

**Pika e parë**

**Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së.**

### **Pika e dytë**

**Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z. Bekim Brestovci a) diskutim mbi sfidat në rajonet ku jetojnë komunitetet joshumicë, b) koordinim i përbashkët i aktiviteteve gjatë vitit 2024.**

**Mirsada Behluli:** – tha se meqë drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike z. Bekim Brestovci nuk i është përgjigjur ftesës, atëherë kjo pikë e rendit të ditës mbetet të shqyrtohet në ndonjërin prej takimeve të ardhshme. Ajo në vazhdim të pranishmit i njoftoi në pika të shkurta se të premtën ka marrë pjesë në takimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi ku në pikën që kishte të bëjë me mbeturinat, ndriçimin, qentë endacakë, pastrimin e rrugëve thaq se në emër të gjithë anëtarëve të Komitetit i kam komentuar të gjitha pakënaqësitë tona të gjithë anëtarëve me punën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

### **Pika e tretë**

**Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit, z. Florian Dushi, a) deponitë ilegale të mbetjeve, b) ndërtimet pa leje.**

Po ashtu edhe kjo pikë e rendit të ditës në mungesë të drejtorit të inspektionit mbetet të shqyrtohet në njërin nga takimet e ardhshme.

### **Pika e katërt**

**Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës, znj. Sibel Halimi**

**Mirsada Behluli:** - duke iu drejtuar znj. Caraku tha se ne sipas planit të punës të Komitetit për Komunitete për çdo vit në muajin mars kemi kontakt me Drejtorinë e Kulturës. Pasi që ju në mars i shpallni këto subvencionet publike, subvencione për të gjitha komunitetet, prandaj ju kisha lutur të na njoftoni rreth këtyre subvencioneve, pasi që ne të gjithë jemi të interesuar për festimin e festave tona nacionale.

**Kimeta Shok:-** unë mendoj që duhet një lajmërim për të gjithë njëjtë.

**Arjona Caraku:** - duke iu drejtuar znj. Behluli tha se sa i përket subvencioneve ato do të jenë publike në web-faqen e komunës, ftesa do të jetë e hapur 1 muaj, kurse ju kërkesat e juaja mund t'i dërgoni në Zyrën për komunitete ku shpresoj që këta i kanë kontaktet dhe kanë me i shpërndarë, si dhe lidhja do të jetë online. Ajo në mes tjerash tha se unë do t'i marr t'i shënoj të gjitha kërkesat e juaja dhe do t'i përcjelli në drejtori tek zyrtarët kompetentë ku ata do t'ju japin përgjigje

**Mirsada Behluli:** - shtroi pyetje se kur mund të aplikojnë.

**Arjona Caraku:** - tha se shpallja është publike domethënë është në web-faqen e komunës kurdo që publikohet veç me përcjellë, 1 muaj ka me qenë e hapur. Kemi menduar tash në fund të marsit, por nuk janë kushtet, kështu që po besoj në fillim të prillit veç kemi me pasur si dhe lidhja do të jetë online.

masa me shume se çfare jemi duke marre. Sa per informachen ju e dimi den ne vitin 2010 per fat te keq qe endacakë janë vrarë dhe prej vitit 2010 është ndryshuar legjislacioni, ndërsa ne nuk guxojmë t'i vrasim dhe assesi nuk dëshirojmë t'i vrasim assesi. Në nivel vendi ekziston programi i kastrimit, sterilizimit, vaksinimit dhe ne si kryeqytet i kemi trajtuar vetëm vitin e kaluar 3600 qen në këtë program. Në kryeqytet për fat të keq janë përi mbi 4000 qen endacakë që sillen rrugëve të Prishtinës. Ai mes tjerash tha se drejtoria ka formuar komisionin që përbehet prej Drejtorisë së Sigurisë dhe drejtorive tjera përkatëse, kemi ftuar edhe shoqata tjera për mbrojtjen e kafshëve që të jenë pjesë e komisionit dhe në suaza të rregullta t'i kontrollojmë, nënshkruhet kontrata me çdo qytetar, nëse nuk e përmbush atë, dënimet janë deri në 3000 euro, por para se me marr kafshën, komisioni e bënë vlerësimin se a i përmbush kushtet në bazë të vlerësimit përmes administratës së bujqësisë.

## **Pika e pestë**

### **Raporti i ZKKK-s për muajin shkurt 2024.**

**Klaudia Mula:** - sa i përket raportit mujor nga Zyra e Komunitetit për Kthim tha se gjatë këtij muaji janë ndërmarrë të gjitha aktivitetet konkrete për zbatimin e planit të punës, siç është riintegrimi i të huajve, kërkesa e përfaqësuesve të komuniteteve nuk kemi pasur diçka, raportin e kemi lexuar nëse ka dikush çka të shtojë jeni të mirëseardhur. E kisha potencuar edhe një gjë se herën e kaluar diskutuam se përpilohet lista e familjeve që janë në gjendje të rëndë ekonomike dhe ne nuk kemi pranuar asnjë listë deri më tani, kjo iu mbetet në përgjegjësi të juaj sigurisht.

**Betim Abdullahu:** - tha se desha për të shtuar edhe një pjesë se Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka hapur thirrjen muajin e kaluar, që secili komunitet që është pjesë e skemave sociale, mund t'i dërgojë fëmijët në një kurs noti. Sipas informatave nga drejtoria nëse nuk gaboje kanë qenë nga 200 euro subvencion, por që nuk i kanë sjellë dëshmitë në drejtori për të arsyetuar pjesëmarrjen e fëmijëve. Megjithëse Fatoni po na mungon në disa mbledhje, nëse dikush prej familjeve ose Nenadi ose prej të tjerët që i kanë dërguar fëmijët në kursin e notit, të na i sjellin dëshmitë për t'i dorëzuar në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale. Unë iu kam kërkuar edhe listën komplet të përfituesve të kursit të notit dhe besoj që ndoshta dikush i njeh edhe secili prej juve ndoshta i njeh familjet e fëmijëve që kanë qenë në kurs dhe krejt kjo është për t'i arsyetuar mjetet e ndara, të cilat janë shpenzuar për atë kurs. Ai mes tjerash të pranishmit i informoi se Ministria e Kthimit, ka nxjerr Rregulloren dhe strategjinë e veprimit, rregulloren e komunitetit 2023-2027, pritet të prezantohet nëpër komuna ku ne ende nuk e kemi pranuar, pritet me e marr edhe pse kemi pasur nga pak kundërshtime, nuk na kanë ftuar në asnjë takim për t'i vendosur pikat tona së bashku për kërkesa, por që na kanë premtuar se kanë me mbajtur sesionin për mundësitë e ndryshimeve për komunitetet që jetojnë në Prishtinë, në mënyrë që ta kenë mundësinë për komente dhe sugjerime. Falemnderit.

**Oktay Kurtesh:** - shtroi pyetje se a mundemi me i përgatitë ne listat dhe as gjysma mos me i marrë. Unë tani me i sjell 50 familje...

**Betim Abdullahu:** - duke iu drejtuar z. Kurtesh tha se nuk ke nevojë ti me iu thënë familjeve na jepni të dhënat për t'i marrë drutë e zjarrit, ti si përfaqësues e din nëse jo 100%, sigurisht 90%, ata të cilët kanë nevojë nuk çon peshë plus-minus, lartë-poshtë në total, ne duhet të dimë një numër për arsye, se çka mundet me ndodh në fundvit edhe tash ne po dalim keq si zyrë edhe ju po mbeteni pa përkrahje. Ne kemi me analizuar deri në gusht ose shtator edhe me Emën edhe me Trierën kemi me u mundu me e gjete një zgjidhje, apo dëshirojmë ta dorëzojmë si kërkesë si buxhet të caktuar për përkrahje, pavarësisht buxhetit në cilën drejtori do të ndahet, me rëndësi ne me t'i kemi paratë e dedikuara për subvencion dhe nuk ka rëndësi tani në cilën drejtori shkojnë paratë në buxhet. Me rëndësi është se ne me pas buxhetin dhe me pas mundësi për të punuar si zyrë, sepse Drejtoria e Mirëqenies Sociale nuk e di sa raste kanë ardhur gjatë vitit me kërkesa për strehim

**BEKIM HODAJANAJ:** - duke u ndërlidhur në diskutim tha se në zyrë gjatë ditës kemi mbledhur dhe kemi shkruar Drejtorisë së Kulturës që t'ju dalin në mbështetje komuniteteve, ndërsa sa i përket shumës, tha se shumata varen prej projekteve që ata i prezantojnë. Ai mes tjerash tha se e kam cekur edhe në muajin që shkoi nëse nuk gaboj ne ju kemi drejtuar secilës drejtori me shkrim, për me i mbështet projektet dhe kërkesat e komiteteve, por edhe projekte që dalin nga zyra jonë që mbështeten realisht çdo vit prej secilit (nuk dëgjohet), kemi me u mundu që në korrik ose në gusht kur bëhet përfundimi i buxhetit me i dërgu këto projekte që i kemi me u buxhetu që mos të dështojnë sikur vitin e kaluar. Kjo është pak a shumë informata.

**Mirsada Behluli:** - duke iu drejtuar të pranishmëve tha se në takimin e Kështillit për Siguri që patëm ishte prezent edhe drejtori për siguri z. Lulzim Fushtica i cili ka shprehur dëshirë për të marrë pjesë në takimin tonë, ku dhe tani i japim mundësinë të na i thotë ca fjalë.

**Lulzim Fushtica:** - për punën në korrektësi dhe për hir të gjithë anëtarëve të Komitetit për Komunitete, me lejoni t'ju falënderoj për mundësinë që më keni dhënë të jem pjesë e këtij takimi. Është hera e parë që unë marrë pjesë në këtë takim dhe unë prej fillimit kam shprehur gatishmërinë dhe vullnetin që të jem pjesë e këtij takimi, duke pasur parasysh se sa për kryeqytetin dhe ekzekutivin e kryeqytetit ka rëndësi siguria dhe mirëqenia e të gjithë anëtarëve të kryeqytetit pa marrë parasysh epitetin apo komunitetin. Dhe për këtë mënyrë një prej arsyeve që është krijuar Drejtoria për Sigurinë dhe Emergjencën vitin e kaluar, ka qenë edhe rritja e komunikimit, rritja e bashkëpunimit dhe rritja e koordinimit me të gjithë qytetarët e kryeqytetit në fushën e sigurisë. Për këtë arsye drejtoria dëshiron që edhe në takimet e radhës të jetë prezent, në mënyrë që t'i dëgjojë nga ju nga përfaqësuesit e komuniteteve hallet, brengat, problemet sa i përket aspektit të sigurisë. Për sot unë do të mbes i hapur nëse keni ndonjë pyetje, koment apo sugjerim, pasi nuk kam qenë pjesë e agjendës, duke marrë parasysh se është takimi i parë nuk kam qenë pjesë e agjendës, kështu që me lejen tuaj kryesuese nëse dikush ka nga anëtarët e komitetit ndonjë kërkesë brengë apo koment, unë jam i gatshëm të përgjigjem me atë sa kam njohuri.

**Mirsada Behluli:** - sa i përket çështjes së sigurisë tha se asnjëherë nuk kemi pasur asnjë problem, kanë qenë disa vjedhje të vogla në Bërniceën e Poshtme në lagjen rome, të cilat janë të lajmëruara në polici dhe me këtë është kryer dhe nuk ka pasur ndonjë problem. Provokime të vogla ndaj komunitetit serb para disa muajve, mirëpo ato ndoshta z. Nenad më mirë ju tregon, nuk ka pasur ndonjë problem etnik, kurse për problemin në fjalë tregon z. Nenad.

**Lulzim Fushtica:** - duke u ndërlidhur në diskutim, tha se më lejoni kryesuese duhet ta kuptojmë që koncepti sigurisht nuk ka të bëjë vetëm me vjedhje, vetëm me incidente, ka të bëjë me konceptin e përgjithshëm se si ne e shohim dhe e ndjejmë veten të sigurt edhe infrastruktura është pjesë e sigurisë edhe shërbimet publike janë pjesë e sigurisë, kështu që ta shikojmë në kontekstin më të gjerë dhe jo vetëm incidentet të vogla që mund të ndodhin, dëshira ime është të punojmë bashkërisht me projekte të përbashkëta që ta rrisim edhe sigurinë edhe mirëqenien e qytetarëve të kryeqytetit.

**Nenad Miladinovic:** - duke u ndërlidhur në diskutim tha se sa i përket sigurisë unë mund të flas për komunitetin serb. Këto probleme nuk janë vetëm të Drejtorisë për Siguri, përgjegjësi ka edhe inspeksioni dhe shërbimet publike. Domethënë nuk janë probleme vetëm të Drejtorisë për Siguri, mirëpo edhe të shërbimeve publike dhe të inspeksionit. Mirëpo problemi me i madh është numri i madh i qenve endacakë dhe mbeturinat.

**Lulzim Fushtica** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se nëse me lejoni që të tregoj një çështje e cila është shumë e rëndësishme dhe shumë problematike jo vetëm për Bërniceë, por për të gjithë Prishtinën kemi të bëjmë me problemin e qenve endacakë. Për fat të keq legjislacioni në fuqi i cili është, nuk na lejon të marrim

... dhe kështu që... Kjo pikë e rendit të ditës u miratua njëzëri.

### **Pika e gjashtë**

#### **Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre.**

**Mirsada Behluli** – shtroi pyetje për të pranishmit se a ka dikush të thotë diçka lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

### **Pika e shtatë**

#### **Të ndryshme**

**Oktay Kurtesh:** - tha se dua të marr një mendim edhe prej Emës, sepse zakonisht po e shoh në rrjete sociale, se Ministria e Kulturës në Prizren është duke rregulluar shumë gjëra, kurse në Prishtinë nuk po rregullon.

**Elmira Nikçi Rexha:** - pse po ma bën mua këtë pyetje, kur të marrim Qeverinë ndoshta, ja Triera ndoshta mundet me u përgjigj, të dyja jemi përfaqësuese në Kuvendin Komunal, por besoj kur të marrim qeverinë bëhet diçka, ne nuk mund të flasim për ministri.

**Oktay Kurtesh:** - shtroi çështjen lidhur me një objekt këtu i cili është ngjitur me komunën, që ka qenë shkolla e parë shqipe, po flas për Prishtinë jo për komunitetin tonë, shtoi se është në kontest pronësor.

**Triera Kasumi Berisha:** - po edhe unë e di se është stopuar për shkak të kontestit pronësor, për këtë rast është dashur t'i drejtoheni drejtorisë së linjës me pyetjen, Drejtorisë së Kulturës.

**Mirsada Behluli** – të pranishmit i informoi se në takimin e Këshillit për Siguri i cili është mbajtur më dt.22.03.2024,. tha se në emër të anëtarëve të Komitetit për Komunitete ka shprehur të gjitha vërejtjet dhe pakënaqësitë për ca drejtori të cilat nuk i përgjigjen ftesës së Komitetit.

Ajo mes tjerash tha se në atë takim pas diskutimit tim drejtori për siguri dhe emergjencë z. Lulzim Fushtica ka shprehur dëshirën që të merr pjesë në takimin tonë sot, ku dhe është ftuar nga ana ime i cili edhe do të na i thotë ca fjalë.

Pas shumë diskutimesh, sugjerimesh dhe propozimesh Komiteti për Komunitete nxori këto;

## **REKOMANDIME**

1. Të ftohet shefi i personelit z. Fadil Aliu ( të na njofton lidhur me respektimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë si në punësim ashtu edhe në përfaqësim);
2. Të ftohet drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit znj. Jehona Lushaku Sadriu;
3. Të ftohet drejtori i Drejtorisë së Sportit z. Bardh Krasniqi ( të na njoftoj lidhur me planin e drejtorisë për vitin 2024 ;
4. Të ftohet zyrtarja për Barazi Gjimore znj. Premtime Preniqi, ( të na njoftoj lidhur me sfidat dhe projektet për vitin 2024;

Faqe 5 nga 6

5. Te gjithë përfaqësuesit de komuniteteve jo shumice te pergatisin dhe sjellin nistat me emra te personave që kanë nevojë për ndihmë me dru zjarri.

Procesmbajtësja  
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit  
Dr.Mirsada Behluli



Faqe 6 nga 6